Shkalle lidhese	12	12	

Dokumentat standarde të tenderit

Semundjet e brendshme Kati per dhe (konsultat)	743.695	743.695	
Semundjet e brendshme Sb1 (kati pare)	657.729		657.729
Semundjet e brendshme Sb2 (kati dyte)	657.729		657.729
Shkalle	60		60
ORL	400		400
Neruokirurgji	560		560
Kirurgja plastike rikostruktive (gastro vip)	561.7		561.7
Laboratori	40	40	
Ish Aviacioni (zyrat ne hyrje te dera kryesore)	86	86	
TOTALI	16556	7955.6	8600.4

Tabela nr.3 Sipërfaqe totale për tu pastruar

Sipërfaqe totale per tu pastruar	Njësia	Sasia	Ditë kalendarike	Sasia vjetore
Pastrim i brëndshem me shërbim 8-orësh	m ²	7,955.6	247	1,965,036.41
Pastrim i brëndshem me shërbim 24-orësh (8600.4 X 3 turne)	m ²	25,801.20	365	9,417,438.00
Totali		33,756.81		11,382,474.41

Ndarja e turneve është përcaktuar sipas nevojave dhe organizimit të punës në SUT.

Specifikimet teknike të Shërbimit të Pastrimit të Brendëshëm

Pastrimi i brendëshëm i organizuar nga ana e një sipërmarrje private ka për detyrë pastrimin dhe dezinfektimin e të gjitha sipërfaqeve të pavioneve, dhomat e të sëmureve, ballkonet, korridoret, tualete, dhoma dushi, dhomat e shërbimit për mjekët, infermierët, kabinetet, zyrat, ambjentet e shfrytëzueshme në bodrume dhe shkallët deri në dalje nga ndërtesa; bën pastrimin dhe dezinfektimin e mureve dhe inventarit në dhoma, sipas specifikimeve teknike si më poshtë :

Pastrimi i ambienteve të brendëshme që do të bëhet cdo ditë sipas specifikave të mëposhtme :

➤ **Dhomat e pacientëve** të pastrohen jo më pak se tre herë në ditë dhe në raste të vecanta edhe më tepër sipas nevojës. Me pastrim të dhomës do të kuptohet marrja e pluhurave mbi mobiljet dhe cdo paisjeje tjetër që ndodhet brënda sipërfaqes së dhomës. Dyshemeja të lahet me solucione të lejueshme për përdorim në ambientet spitalore. Qeset e mbeturinave të zbrazen jo më pak se dy herë në ditë dhe sipas rastit në cdo moment të ditës. Pastrimi në dhoma nuk bëhet në orarin e ngrënies së ushqimit dhe në oraret e kryerjes së vizitave të mjekut.

➤ **Korridoret, shkallët dhe ashensorët** të pastrohen jo më pak se tre herë në ditë dhe në rast nevoje edhe më tepër. Solucionet që do të përdoren duhet të jenë të lejueshme për këto ambiente.

➤ **Pastrimi i Tualeteve** në dhomat e pacientëve do të bëhet 2 herë në ditë dhe në rast nevoje edhe më tepër. Për tualetet kolektive jo më pak se 4 herë në ditë. Tualetet e personelit të pastrohen 1 herë në ditë. Mbas cdo pastrimi të bëhet dhe dizinfektimi i tyre. Bidetë, vaskat dhe pjatat e dushit të pastrohen sa herë të jetë e nevojshme (sipas kërkesave të personelit të SUT). Pastrimi i sifonëve të tualeteve jo më pak se 3 herë në javë. Larja bëhet me solucion dizinfektues. Në ambientet e tualeteve të përdoren solucione aromatike.

➤ **Pastrimi i zyrave dhe dhomave të personelit (mjekësor dhe atij mbështetës), laboratorët, farmacia, fizioterapia**

Me këtë shërbim do të kuptojmë: Heqja e mbeturinave nga koshat, fshirja e larja e dyshemeve dhe marrja e pluhurave në të gjitha orënditë e vendosura në zyrë. Në dhomat e personelit ky pastrim të bëhet të paktën 1 herë në ditë.

➤ Laboratorët, fizioterapia dhe farmacia të pastrohen të paktën 2 herë në ditë. Solucionet që do të përdoren duhet të jenë të lejueshme për këto ambiente.

➤ **Pastrimi i dhomave të teknikës (imazheria)**

Me këtë shërbim do të kuptojmë: Heqja e mbeturinave nga koshat, fshirja e larja e dyshemeve me solucion përkatës dhe marrja e pluhurave në të gjitha orënditë e vendosura në këto ambiente. Ky pastrim të bëhet të paktën 2 herë në ditë. Sanitaret nuk duhet të pastrojnë dhe të prekin aparatat e vendosura në këto ambiente.

Pastrimi i ambienteve të brendëshme që do të kryhet të paktën një herë në javë

➤ Të pastrohen sipërfaqet e mureve dhe tavaneve. Aty ku muri është i lyer me bojë vaji apo pllaka të lahen me solucion.

➤ Të zhvendosen dollapet dhe mobiljet e mëdha dhe të pastrohet pjesa e mbrapme e tyre.

➤ Të pastrohen dritaret e fasadës si dhe dritaret e brendëshme me solucion larës.

➤ Të pastrohen dyert e brendëshme dhe të jashtme me solucion larës.

➤ Pastrimet javore të bëhen sipas kërkesave të personelit të SUT në ditën e përcaktuar prej tij.

Pastrimi i ambienteve që do të kryhen të paktën një herë në muaj

- Do të pastrohet sistemi i të gjithë llojeve të ndriçimit (abazhurë, llampadarë etj).
- Pastrimet mujore të bëhen sipas kërkesave të personelit të SUT në ditën e përcaktuar prej tij.

Në ambientet e reanimacionit dhe urgjencës

- Pastrimi të bëhet i pandërprerë sipas nevojës gjatë 24-orëve. Dyshemeja të lahet me solucione të lejueshme për përdorim në këto ambiente spitalore sipas Listës së lëndëve DDD, e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Të pastrohen sipërfaqet e mureve dhe tavaneve sa herë të jetë e nevojshme sipas kërkesave të personelit përkatës në këto pavione por jo më pak se 2 herë në javë.

Sallat e operacionit

- Cdo ditë një orë para operacionit kryhet pastrimi dhe dizinfektimi
- Po kështu pastrohen edhe sipërfaqet e paisjeve dhe orenditë e sallave duke përdorur pecetë të njomë me solucion larës dhe dizinfektantë.
- Pas cdo operacioni kryhet pastrimi dhe dizinfektimi i dyshemesë së sallës me solucion larës e dizinfektues, për përdorim spitalor (i specifikuar për sallat e operacionit).
- Në fund të ditës së punës kryhet pastrimi dhe dizinfektimi i sallës.
- Sanitarja nuk prek instrumente kirurgjikale dhe aparaturat e instaluar në sallë, pastron e dezinfekton ambientin e bllokut operator. Mbeturinat e sallës i izolon hermetikisht dhe i dërgon në inçinerator për djegie sipas ndarjes së tyre.

Dhomat e mjekimit

- Të pastrohen sa herë që është e nevojshme gjatë gjithë kohës që janë në përdorim.

Të gjitha dhomat

- Dhomat e pacientëve, infermieritë, dhomat e mjekimit, zyrat, ambientet e përbashkëta, laboratorët, poliklinika etj., duhet të pajisen me kosha (kur ato mungojnë) për hedhjen e mbeturinave dhe me qese plastike të zeza njëpërdorimshe. Qeset e mbeturinave do të ndërrohen sa herë të jetë e nevojshme (sipas kërkesës së personelit të SUT)

Dezinfektimi i dyshemeve, qosheve dhe tualeteve bëhet me lëndë dezinfektuese çdo ditë. Kur përdoren dezinfektantë duhet të zbatohen pikat e përgjithshme të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore. Produktet që do të përdoren për dezinfektim duhet të jenë të certifikuara.

Pastrimi i sipërfaqes bëhet me shtupë me dy kova ujë, një për larje, një për shplarje. Mjetet e pastrimit për tualetet mbahen të veçanta, fshesa përdoret e kufizuar në ambientet pa shtretër dhe që kanë qarkullim të lartë (shkallë, koridore, konsultat, etj.)

Grumbullimi i mbeturinave dhe ndarja e tyre bëhet në koshat e vendosur në çdo dhomë dhe ambjent të veshur me qese të zeza plastike. Mbeturinat, materialet biologjike dhe të mjekimit (Mbetjet infektive spitalore) grumbullohen në qese të verdha të posaçme dhe dërgohen për djegie në inçenerator. Mbetje të rrezikshme (Mbetje citotoksike, Medikamente, Kimikate të tjera farmaceutike, Mbetje radioaktive, Mërkur dhe Metale të tjera të rënda, p.sh. Bateritë Ni-Cad etj.) grumbullohen në kuti të kyçura farmaceutike, kontenitorë të verdhë farmacie me shënimin “Të rrezikshme nga farmacia” dhe dërgohen për djegie në inçenerator.

Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për në vend grumbullimin e plehrave bëhet çdo ditë, transporti bëhet me kosha të mëdhenj, të posaçem, të mbyllur me kapakë. Firma kontraktuese duhet të bazohet në “Ligjin për administrimin e mbetjeve spitalore” dhe Udhëzuesin Kombëtar “Për administrimin e sigurt të mbetjeve Spitalore”.

Kontraktuesi duhet të mirëmbajë dhe të bëjë zëvendësimin e koshave të dëmtuar apo kur mungojnë në cdo ambjent të nevojshëm të SUT. Zëvendësimi i tyre do të bëhet me shpenzimet e kontraktuesit.

Larja dhe dezinfektimi i inventarit ndihmës të pacientit si uturakë, legena, bacinela etj. Të bëhet çdo ditë sa herë është e nevojshme dhe të përdoret solucion detersiv dhe dezinfektues 10%.

Sanitarja gjatë pastrimit nuk duhet të prekë pacientet, aparaturat, dorezat e dyerve.

Personeli i shërbimit duhet të ketë uniformë të dallueshme nga personeli spitalor. Në uniformë duhet të dallohet logo e kompanisë, me ngjyrë të ndryshme nga uniforma e spitalit. Personeli duhet të instruktohet për mbrojtjen nga infeksionet spitalore sipas ligjit “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve ngjitëse”.

Në ambientet spitalore personeli i pastrimit duhet të përdori mjete mbrojtëse si doreza plastike, maska, këpucë gome etj.

Në ambjentet publike si korridore, salla, shkallë etj., të përdoren tabela provizore ku të paralajmërohet për dysheme të lagur e të rrëshkitshme.

Shërbimi i pastrimit duhet të vazhdojë gjatë 24 orëve pa ndërprerje (sipas ndarjes së orareve të përcaktuara në këtë studim).

Firma kontraktuese është e detyruar të vendosi sahat matës për ujin i cili do të përdoret për larjen e sipërfaqeve të brendëshme, në një pikë të caktuar në bashkëpunim me SUT.

Në rast se firma kontraktuese e ka të nevojshme të marrë me qera ambiente të SUT-së për magazinimin e materialeve do të bëhet sipas VKM Nr. 54 datë 5.2.2014 e cila është e detyruar të lidhë kontratë qeraje dhe të vendosi gjithashtu sahat matës për energjinë elektrike. Me mbarimin e kontratës i dorëzon ambientet në gjëndje të rregullt dhe të gjitha riparimet që do të kryejnë në to do të ngelen pjesë e SUT. Shpenzimet që bën për riparimin, mirëmbajtjen dhe rikonstruksionet e nevojshme përballohen nga vetë sipërmarrsi. Për instalime të reja teknologjike që mund të bëhen nga sipërmarrsi, me përfundimin e kontratës ato i mbeten SUT-së.

Të sigurojë bazën materiale të inventarit për pastrim si dhe materialet dezinfektuese të përshtatshme dhe të lejueshme për përdorim në ambientet spitalore. Siguron inventarin për grumbullimin e mbeturinave në dhoma, koridore etj.

Firma kontraktuese duhet të sigurojë numrin e nevojshëm të personelit për kryerjen e pastrimit në të gjithë territoret e SUT. Ky personel duhet të jetë i përshtatshëm dhe i instruktuar për kryerjen e shërbimit të pastrimit sipas rregullave dhe duhet të jetë i pajisur me librezat shëndetësore personale.

Sipërmarrsi ndërton stafin e vet drejtues. Në çdo korpus kryesor cakton përgjegjësin e vet të pastrimit i cili ndjek, organizon e drejton punën në korpus.

Detyrat e Kontraktuesit

- Veshja e punonjësve do të jetë sipas kërkesave të SUT-së.
- Personeli të jenë bashkëpunues, për çdo të papritur dhe tu përgjigjen kërkesave dhe rregullores së SUT-së.
- Trajnimi i personelit të pastrimit do të bëhet me shpenzimet e kontraktuesit.
- Sipërmarrësi është i detyruar të sigurojë me shpenzimet e veta pajisjet, makineritë dhe veglat e punës që nevojiten për përmbushjen e kontratës. Këto pajisje, makineri dhe vegla duhet që sipërmarrësi ti sigurojë që me fillimin e punës.
- Makineritë dhe veglat e punës:
 1. Dy makineri larëse për ambientet e brendshme
 2. Vinç me kosh për larjen e dritareve në lartësi
 3. Karrela për pastrimin (të paktën 20 copë) me të gjitha mjetet e nevojshme për pastrim dhe cdo mjet pune tjetër të nevojshëm për kryerjen e shërbimit të pastrimit.

Të gjitha makineritë dhe veglat e punës Kontraktuesi duhet ti ketë gjëndje në inventarin e tij.

MENAXHIMI I SHËRBIMIT TË PASTRIMIT TË BRENDËSHËM


- Shërbimi i pastrimit të sipërfaqeve të brendshme do të ndiqet nga grupi i punës i përcaktuar me urdhër të brendshëm (grupi i ndjekjes së kontratës).
- Sipërmarrësi do të përcaktojë drejtuesin teknik, i cili koordinon punën me stafin e tij dhe mban kontakte të vazhdueshme me grupin e punës në SUT.
- Përgjegjës për ndiekjen e punës që do të kryhet nga sanitaret nëpër pavione do të jenë kryeinfermieret sipas pavioneve përkatëse.
- Kryeinfermierët e pavioneve duhet të mbajnë një regjistër në të cilin do të pasqyrojnë cdo ditë shërbimin e kryer nga sanitaret sipas specifikimeve teknike të kërkuara.
- Cdo fund muaji ecuria e punës do të pasqyrohet në procesverbal të posacëm dhe do ti

- dorëzohet ndjekësve të kontratës për të përgatitur akt rakordimet mujore.
- Cdo fillim muaji shefi i shërbimeve të brendëshme duhet të miratojë një plan kontrolli të detajuar sipas pavioneve.
 - Ndjekësit e kontratës duhet të kryejnë kontrole periodike për të verifikuar ecurinë e shërbimit. Cdo problem apo mangësi e konstatuar do të pasqyrohet në proces-verbal dhe do të bëhet përlllogaritja e dëmit të shkaktuar ndaj SUT dhe do të zbritet nga fatura.
 - Kur sipërmarrsi nuk e kryen pastrimin në një rast të dhënë, mbi bazën e proces-verbalit që mbajnë ndjekësit e kontratës me kryeinfermierët e njesisë sipas pavioneve dhe përgjegjësin e sipërmarrësit, bëhet ndalesë në faturë për punën e pakryer.
 - Për problematikat që mund të krijohen midis palëve (ndjekësit e kontratës dhe kryeinfermierët e shërbimit nga njëra anë dhe përfaqësuesit të sipërmarrësit nga ana tjetër) do të mbahen procesverbale dhe do të dorëzohen Titullarit të Institucionit.

2. MBI SHËRBIMIN E PASTRIMIT TË AMBJENTEVE TË JASHTME

Me sipërfaqet e jashtme (rrugë, trotuare, sheshe parkimi dhe hapësirat e gjelbërta) të Spitalit Universitar të Traumës do të kuptojmë të gjithë hapësirën rreth e përfaqë godinave (objektet e ndërtimit) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali. Të gjitha sipërfaqet, pronë e SUT-së janë të pasqyruara në hartën topografike bashkangjitur këtij studimi.





SPECIFIKIMET TEKNIKE PASTRIMI I JASHTËM

- Pastrimi, sistemimi i ambienteve të jashtme.
- Shërbimi i Pastrimit të ambienteve të jashtme që kërkohet do të jetë 8 orarësh sipas tabelës me të dhënat e sipërfaqeve si më poshtë:

Tabela Nr. 1

Nr	Sipërfaqet e jashtme	Njësia	Sasia	Pastrim i sipërfaqeve/ ditë	Larja e sipërfaqeve nga 15 Mars deri në 31 Tetor

Dokumentat standarde të tenderit

1	Rrugë	m ²	8651.9	365	230
2	Trotuare	m ²	2664.3	365	230
3	Parking	m ²	3276.1	365	230
4	Sipërfaqe të tjera të betonuara	m ²	1739	365	230
	Totali I sip. Të jashtme	m²	16331.3	365	230

Shenim: Të dhënat e tabelës së mësipërme janë përlogaritur nga Inxhinieria e SUT duke u bazuar në të dhënat e hartës topografike të punuar nga gjeodetë të certifikuar për matjet e sipërfaqeve që janë pronë e SUT duke zbritur nga totali sipërfaqet në përdorim nga të tretë.

- Me pastrim të jashtëm do të kuptohet pastrimi i sipërfaqeve të rrugëve, trotuareve, shesheve dhe të gjithë territorit pjesë që aktualisht përdoret nga Spitali Universitar i Traumës.
- Bordurat duhet të mirëmbahen dhe lyhen me gëlqere të paktën një herë në muaj.
- Pastrimi i territorit do të kryhet jo më pak se një here në ditë. Pjesët e asfaltuara dhe të betonuara do të lahen me ujë të paktën 1 (një) herë në ditë sipas sezonit për të eliminuar pluhurat dhe mikrobet (por jo në ditët me shi).
- Territori i SUT në cdo moment duhet të jetë i pastër nga mbeturinat e ndryshme si letra, shishe plastike, ambalazhe të ndryshme etj.
- Mbeturinat që do të pastrohen të futen në qese plastmase dhe të cohen në pikat e grumbullimit të mbeturinave. Duhet ndërruar të paktën një herë në ditë qeset plastike në koshat e vendosura në territorin e jashtëm të SUT-së si dhe duhet të mirëmbahen këto kosha (të zëvendësohen në rast dëmtimi).
- Në asnjë rast mbeturinat të mos digjen.
- Sipermarresi kryen larjen e rrugëve cdo ditë herët në mëngjes, para ores 7.00 për periudhen 15 Mars - 31 Tetor, pra gjithsej 230 ditë.
- Larja e sipërfaqeve të jashtme (sipas tabelës) do të bëhet me makinë larëse (autobot), në pronësi ose me qera të Kontraktuesit dhe jo me ujin e SUT-së .
- Sipërmarrësi është i detyruar të mirëmbajë stolat të cilat ndodhen në territorin e SUT-së. Në total stola në SUT janë 31 copë.
- Kontraktuesi duhet të sigurojë me shpenzimet e veta mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e koshave të mbeturinave të vendosur në të gjithë territorin e SUT-së.
- Kontraktuesi duhet të mirëmbajë me shpenzimet e veta stolat e pushimit të vendosur në ambientet e jashtme të SUT-së.

Detyrat e kontraktuesit

- Veshja e punonjësve do të jetë sipas kërkesave të SUT-së.
- Personeli të jetë bashkëpunues, për çdo të papritur dhe tu përgjigjen kërkesave të SUT-së.
- Trajnimi i personelit të pastrimit do të bëhet me shpenzimet e kontraktuesit.

Loti III: "Shërbim pastrimi për QSUT" për periudhën 01.06.2018 deri më 31.12.2018,

MIRËMBAJTJA DHE PASTRIMI I RRJETIT RRUGOR DHE SHESHEVE NË QSUT

Për pastrimin ditor të territorit të QSUT-së, është e rëndësishme ndarja e këtij territori në zonat e mëposhtme, në mënyrë që mbulimi i pastrimit të territorit të bëhet në oraret e përcaktuara në grafikun bashkangjitur.

Çdo ditë, çdo zonë e poshtë shënuar deri në kufijtë e territorit të zonave, do të pastrohet nga 2 punëtorë pastrimi, të cilët do të pastrojnë territorin përgjatë, përreth godinave të cdo zone, fshirjen e rrugëve, shesheve, trotuareve të zonës, dhe mbledhjen e mbeturinave të koshave metalikë. Pas pastrimit në orët e para të mëngjesit ora 06:00, në interval kohor cdo 2 orë do të ketë patrullimin e 2 punëtorëve të pastrimit, për zonën përkatëse.

Zona e parë, përfshin territorin nga Hyrja Kryesore për në QSUT, Spitali Onkologjik përreth gjithë sipërfaqes së tij, Akseleratorin Onkologjik, Godinën e Spitalit Infektiv dhe sipërfaqet përreth tij, Godina e Konsultave, si dhe parkingjet e QSUT në këtë zonë (P1 – 3850 m2, P8-500m2 referuar hartës bashkëngjitur);

Zona e dytë, përfshin godinën e Djegie Plastikës (para dhe mbrapa saj), Klinikat Kirurgjikale (rreth klinikave nga jashtë dhe brënda), Spitalin e Ri (Urgjencat), Spitalin Nr.1 (6 katëshin) përpara dhe pjesën mbrapa, Depon qendrore të kaldajave, Mjekësinë Ligjore, si dhe parkingjet e QSUTsë përreth këtyre zonave (P7-300m2, P9-1300m2, P4-850m2);

Zona e tretë, përfshin Godinën e Statistikës (ish-rektorati), të dy godinat e Pediatrive dhe përreth tyre, dhe parkingjet e QSUT-së përreth tyre (P5 – 1000m2, P6 – 540 m2).

Zona e katërt, përfshin Magazinat e Farmacisë Qëndrore, Drejtorinë e Përgjithshme, Depon Qëndrore të ujit, Spitalin Francez, Godinën e Kardiokirurgjisë dhe Kirurgjisë Vaskulare, rrugën mbrapa spitalit francez (rruga shamenti) deri tek hyrja/dalja e peditrisë, si dhe parkingjet e QSUT-së përreth tyre P2-250m2, P3-750m2);

Zona e pestë, përfshin Spitalin Nr.5 (Neurologjinë, Neurokirurgjinë, Shërbimin e Psikiatrisë), dhe parkingjet përreth territorit të tyre;

Sezoni Verë

Fillon nga ora 06:00 deri në orën në 20:30

Turni i paradites: 06:00 – 14:30

Turni i pasdites: 14:30 – 20:30

Sezoni Dimër

Fillon nga ora 06:00 deri në orën në 19:30

Turni i paradites: 06:00 – 14:30

Turni i pasdites: 14:30 – 20:30

Mbledhja e mbetjeve urbane në godinat spitalore do të bëhet 3 - 4 herë në ditë, sipas orareve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. (çdo pavion një kosh + qese pletrash).

1 herë/javë pastrim gjeneral.

Aktiviteti Ditor i Pastrimit të Jashtëm të territorit të QSUT-së.

- Mbetjet urbane do të merren me kamionçinë 3(tre) – 4(katër) herë në ditë, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor pranë çdo shërbimi spitalor (godinë).

Sipërmarrësi, menjëherë do të furnizojë të gjitha godinat spitalore me kosha për mbeturinat urbane (150 litërsh material plastik me ngjyrë me kapak, me rrota në njërën anë), të identifikuar me etiketën përkatëse, për secilin shërbim spitalor. Gjithashtu, do të kryejë dhe furnizimin me etiketa me emrat e çdo shërbimi, të cilat do të vendosen nga shërbimi në qeset e zeza të mbeturinave urbane që do nxjerrin çdo ditë gjatë 3 orareve të përcaktuara.

Public Health Sector

Pastrimi i ambienteve: shesheve dhe i rrugëve, do të nisë çdo ditë në orën 05:00 në mëngjes, përgjatë periudhës së pranverës dhe verës, dhe në fillim të vjeshtës. Në sezonin e dimrit, procesi i pastrimit do të nisë në orën 06:00.

Ky proces shumë i rëndësishëm dhe do të kryhet në dy turne, ku nuk do të mungojë për asnjë çast patrullimi i punëtorëve, për të mbajtur pastër ambientet e jashtme si sheshet dhe rrugët, koshat metalikë rrotullues të territorit të jashtëm, ashtu edhe sipërfaqet e gjelbra të QSUT-së.

Punëtorët do të jenë të veshur me veshjet përkatëse identifikuese të paisur me doreza (të miratuara nga Autoriteti Kontraktor), me kartat identifikuese të personelit (të miratuara nga Autoriteti Kontraktor), si dhe do të zbatojnë rregullat e brendshme, rregulloren e monitorimit të këtij shërbimi, të vendosura nga Q.S.U.T-ja.

Kërkesa specifike për O.E. gjatë sezonit të dimrit:

Në periudhën e dimrit, do të ketë larje të rrugëve dhe shesheve çdo ditë, do të ketë edhe larje të fasadave të spitaleve, xhamave të lartë, me makina teknologjike specifike dhe të pjesëve të futura/xhëpave rreth godinave, për largimin e papastërtive në parandalimin e përhapjes së infeksioneve të ndryshme, sipas një plani të hartuar dhe miratuar në bashkëpunim me Sektorin e

Infeksioneve Spitalore dhe Sektorin Infermieristik

Kërkesa specifike për O.E. gjatë sezonit të verës:

Në periudhën e verës, do të ketë larje të rrugëve dhe shesheve çdo ditë, do të ketë edhe dhe larje më të shpeshta të fasadave të spitaleve, xhamave të lartë, me makina teknologjike specifike, dhe të pjesëve të futura/xhepave rreth godinave, për largimin e papastërtive në parandalimin e përhapjes së infeksioneve të ndryshme, sipas një plani të hartuar dhe miratuar në bashkëpunim me Sektorin e Infeksioneve Spitalore dhe Sektorin Infermieristik.

Për këtë, O.E duhet të vendosë në dispozicion: makinerinë specifike për larjen e fasadave, botin me ujë, solucionet e duhura, si dhe punëtorët aty ku do të jetë e nevojshme. Pjesë e këtij pastrimi gjeneral do të jenë, edhe sektorë të tjerë si Sektori i Infermieristik dhe të Infeksioneve Spitalore.

Për të patur një ambient të pastër dhe të gjelbër në shërbim të pacientit, O.E do të vendosë kosha të vegjël metalikë rrotullues, për hedhjen e mbeturinave nga familjarët e pacientëve, kalimtarët (vendet e tyre do të përcaktohen nga Autoriteti Kontraktor), si dhe tabela ndërgjegjësuese në mirëmbajtjen dhe mosdëmtimin e sipërfaqeve të gjelbra (specifikimet mbi mesazhet ndërgjegjësuese dhe tabelat do të bëhen sipas marrëveshjes me AK).

O.E është i detyruar të mirëmbajë, të gjithë bazën materiale që do të jetë në funksion të këtij shërbimi (tabela, kosha, etj), dhe në rast dëmtimi duhet ti rregullojë ose ti zëvendësojë.

Në orarin e pushimit të punëtorëve, duhet të jetë disponibël një patrullë lëvizëse në territorin e QSUT-së, për heqjen e mbeturinave rastësore nga këto sipërfaqe ose koshat e vegjël.

Kosha mbeturinash të pajisura me kapak për fikjen e cigareve + qese plehrash sipas pozicioneve që do të përcaktojë QSUT.

Tabela Ndërgjegjësuese në QSUT, për mbajtjen pastër të ambientit dhe mos shkeljen e hapësirave të gjelbra, 30 copë.

1. Larje e rrjetit kryesor rrugor me makinë teknologjike.
2. Larje e shesheve, shesheve të parkingut të QSUT-së.
4. Fshirja e shesheve, rrjetit rrugor, trotuareve, sheshit të parkingut
3. Prerje barishtesh në rrjetet rrugore
5. Mirëmbajtje e pusetave të ujrave të bardha
6. Larja e rrjetit rrugor dhe shesheve me ujë me presion.
7. Largimi/transport ditor i mbeturinave nga godinat e shërbimeve shëndetësore (**3 -4 herë në ditë**).

Loti IV: "Shërbim pastrimi për Shkollën e Administratës Publike", për periudhën 01.06.2018 deri më 31.12.2018

Specifikimet teknike për Shërbimin e pastrimit të mjediseve të brendshme dhe të jashtme të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike

- Periudha e kryerjes së shërbimit Qershor- Dhjetor 2018
- Për kryerjen e këtyre proceseve të punës, sipërmarrësi është i detyruar të sigurojë me shpenzimet e veta pajisjet, veglat e punës, veshmbathjet dhe makineritë e nevojshme për përmbushjen e punëve. Këto pajisje, vegla pune, veshmbathje dhe makineri, sipërmarrësi duhet t'i sigurojë në momentin e fillimit të punës.
- Pastrimin e sipërfaqeve të dysHEMEVE (salla trajnimit dhe zyra) 1 herë/ditë (fshirje, larje, dizinfektim), heqje mbeturinash nga koshat e letrave. Pastrimin e sipërfaqeve të korridoreve dhe shkallëve 2 herë/ditë (fshirje, larje) **Sip m² 1300**
- Pastrim sipërfaqesh xhamave 1 herë/muaj (larje) .Pastrim sipërfaqesh Dyersh 2 herë/muaj (larje) **Sip m² 250**
- Pastrim sipërfaqesh Banjo + Veshje anësore 2 herë/ditë **Sip m² 220**

- Gjithë sipërfaqja e sheshit, (për periudhën 7 mujore) do të fshihet çdo ditë efektive të punës, 21 dite x 10 muaj, gjithsej **për 147 ditë**, për një volum ditor **1100 m²**
- Pastrimin një herë në muaj të sipërfaqes së jashtme me pllaka për një volum **500 m²**
- Spërmarrësi duhet të sigurojë **2 punëtorë** pastrimi të cilat do të jenë prezente çdo ditë dhe do të mbulojnë pastrimin e ambienteve të ASPA-s;
- Sipërmarrësi do të kryej 2 herë në javë transportimin e mbeturinave të përqëndruara në kontenierë. Grumbullimi i mbeturinave është i përqëndruar në 1 pikë.
- Sipërmarrësi mbas largimit të mbeturinave do të bëjë dezinfektimin dhe klorifikimin e vendgrumbullimit të mbeturinave, rreth kontenierit/ve metalik.
- Pastrimi i sipërfaqeve do të bëhet sipas specifikimeve të përshkruara më sipër dhe në raste të vecanta edhe më tepër sipas nevojës
- Sipërmarrësi do të sigurojë brenda këtij shërbimi të gjitha materialet e konsumit të përdorimit të përditshëm si dhe aksesore për vendosje letër higjienike, aksesore për vendosje letër duarsh, ose tharëse duarsh, kosha mbeturinash për zyra, korridore e tualete, letër higjienike, letër duarsh dhe të gjitha materialet e nevojshme për realizimin e këtij shërbimi.
- Ofertuesit duhen të jenë agjenci të specializuara ose kompani që merren me shërbime të tilla.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Loti I "Sherbim pastrimi per Departamentin e Administrates Publike"							
Emërtimi	Njësi a	Sasia	Frekuenca/ditë	Vol ditor	Vol total	Çmimi per njesi	Vlefte pa tvsh
Sipërfaqe Dysheme + Korridore + shkallë	m2	737	1	737	113,498		
Sipërfaqe dritare + vetrata	m2	1,012	0.05	50.6	7,792		
Sipërfaqe Banjo+Veshje anësore	m2	114	2	228	35,112		
Pastrim mirëmbajtje rruge dhe sheshe	m2	1,000	1	1000	154,000		
Fondi Limit pa tvsh							674,064

Loti II "Sherbim pastrimi per Spitalin Universitar te Traumes"							
Nr	Sipërfaqe totale për tu pastruar	Njësia	Sasia	Ditë kalendarike	Sasia vjetore	Çmimi per njesi	Vlera pa tvsh
1	Pastrim i brëndshem me shërbim 8-orësh	m ²	7,955.60	247	1,965,033.20		
2	Pastrim i brëndshem me shërbim 24-orësh (8600.4 X 3 turne)	m ²	25,801.20	365	9,417,438.00		
	Totali i sip te brendeshme		33,756.80		11,382,471.20		
3	Siperfaqet e	m ²	16,331.30	365	5,960,925		

Dokumentat standarde të tenderit

	jashtme per tu pastruar						
4	Siperfaqet e jashtme per tu lare	m ²	16,331.30	230	3,756,199		
Totali i siperfaqeve te jashtme							
Totali i pastrimit te siperfaqeve te brendeshme dhe te jashtme per nje vit pa tvsh							28,860,706
Fondi limit pa tvsh per tre vjet							86,582,118

Loti III "Sherbim pastrimi per QSUT"							
Nr	Përshkrimi i punimeve (shërbimeve)	Njësia	Sasia	Frekuenca/ muaj	Volumi Total	Çmimi per njësi	Vlera pa tvsh
1	Pastrim i rrjetit rrugor+trotuare me krahë (fshesë) t.1	m2	16,190	214	3,464,660		
2	Pastrim i rrjetit rrugor+trotuare me krahë (fshesë) t.2	m2	8,000	214	1,712,000		
3	Prerje barishtesh në koordinatat e rrjetit rrugor	m2	350	7	2,450		
4	Mirëmbajtje e pushtave të ujërave të bardha	copë	100	7	700		
5	Larje e rrjetit rrugor me ujë nën presion	m2	10,940	70	765,800		
6	Larje e shesheve me ujë nën presion	m2	15,980	70	1,118,600		
7	Largimi i mbeturineave nga godinat e shërbimeve spitalore me komionçinë 3 - 4 herë/ditë QSUT-Landfill (sipas kërkesës së A. K.-së)	kg	12,000	214	2,568,000		
Fondi limit pa tvsh							4,339,383

Loti IV "Sherbim pastrimi per Shkollen e Administrates Publike"

Dokumentat standarde të tenderit

Emërtimi	Njësia	Sasia	Frekuenca/ditë	Vol ditor	Vol total	Çmimi per njesi	Vlera pa tvsh
Sipërfaqe Dysheme + Korridore + shkallë	m2	1,300	1	1,300	191,100		
Sipërfaqe dritare + vetrata	m2	250	0.05	13	1,838		
Sipërfaqe Banjo+Veshje anësore	m2	220	2	440	64,680		
Sipërfaqe e jashtme pllaka	m2	500	0.05	25	3,675		
Pastrim mirëmbajtje rruge dhe sheshe	m2	1,100	1	1,100	161,700		
Heqje mbeturinash + dizinfektim	kazane	1	0.4	0.4	58.8		
Totali pa Tvsh							1,264,053



Afatet e ekzekutimit:

Loti I "Shërbim pastrimi për Departamentin e Administratës Publike", për periudhën 01.06.2018 deri më 31.12.2018;

Loti II: "Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar te Traumës" për një periudhë 3(tre) vjet nga lidhja e kontratës;

Loti III: "Shërbim pastrimi për QSUT" për periudhën 01.06.2018 deri më 31.12.2018

Loti IV: "Shërbim pastrimi për Shkollën e Administratës Publike", për periudhën 01.06.2018 deri më 31.12.2018

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Loti I "Shërbim pastrimi për Departamentin e Administratës Publike", për periudhën 01.06.2018 deri më 31.12.2018.

Loti II: "Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar te Traumës" për një periudhë 3(tre) vjet nga lidhja e kontratës,

➤ Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Pastrimi, përmirësimi dhe arritja e një shërbimi optimal sipas standarteve në protokollet përkatëse kombëtare si dhe bazuar në legjislacionin Shqiptar, VKM-ve të dala në zbatim të tyre dhe cdo udhërrëfyes e rregullore e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Mjedisit për ruajtjen e kushteve tekniko-sanitare dhe higjienike në Spitalin Universitar të Traumës.

➤ Detyrat:

Sipërmarrësi do të përcaktojë drejtuesin teknik, i cili koordinon punën me stafin e tij dhe mban kontakte të vazhdueshme me grupin e punës në SUT. Shërbimi i pastrimit duhet të vazhdojë gjatë 24 orëve pa ndërprerje (sipas ndarjes së orareve të përcaktuara në këtë studim).

Firma kontraktuese është e detyruar të vendosi sahat matës për ujin i cili do të përdoret për larjen e sipërfaqeve, në një pikë të caktuar në bashkëpunim me SUT.

Në rast se firma kontraktuese e ka të nevojshme të marrë me qera ambiente të SUT-së për magazinimin e materialeve do të bëhet sipas VKM Nr. 54 datë 5.2.2014, dhe është e detyruar të lidhë kontratë qeraje dhe të vendosi gjithashtu sahat matës për energjinë elektrike. Me mbarimin e kontratës i dorëzon ambientet në gjëndje të rregullt dhe të gjitha riparimet që do të kryejë në to do të ngelen pjesë e SUT. Shpenzimet që bën për riparimin, mirëmbajtjen dhe rikonstruksionet e nevojshme përballohen nga vetë sipërmarrsi. Për instalime të reja teknologjike që mund të bëhen nga sipërmarrsi, me përfundimin e kontratës ato i mbeten SUT-së.

Të sigurojë bazën materiale të inventarit për pastrim si dhe materialet dezinfektuese të përshtatshme dhe të lejueshme për përdorim në ambientet spitalore. Siguron inventarin për grumbullimin e mbeturinave në dhoma, koridore etj.

Firma kontraktuese duhet të sigurojë numrin e nevojshëm të personelit për kryerjen e pastrimit

Dokumentat standarde të tenderit

në të gjithë territoret e SUT. Ky personel duhet të jetë i përshtatshëm dhe i trajnuar për kryerjen e shërbimit të pastrimit sipas rregullave dhe duhet të jetë i pajisur me librezat shëndetësore personale.

Sipërmarrësi është i detyruar të sigurojë me shpenzimet e veta të gjitha pajisjet, makineritë dhe veglat e punës që nevojiten për përmbushjen e kontratës. Këto pajisje, makineri dhe vegla duhet që sipërmarrësi ti sigurojë që me fillimin e punës.

➤ Vendi i kryerjes së shërbimeve: **Spitali Universitar i Traumës.**

Loti III: "Shërbim pastrimi për QSUT" për periudhën 01.06.2018 deri më 31.12.2018,

Loti IV: "Shërbim pastrimi për Shkollën e Administratës Publike", për periudhën 01.06.2018 deri më 31.12.2018.



Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Loti I - Departamenti i Administratës Publike, Tiranë

Loti II- Spitali Universitar te Traumës, Tiranë

Loti III- Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë

Loti IV- Shkolla e Administratës Publike, Tiranë

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :



Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të

Dokumentat standarde të tenderit

shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____



[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Public Health Sector

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Dokumentat standarde të tenderit

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____
2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES **Shërbimet – Procedura e Hapur**

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
